



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Komuna e Drenasit

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Nr. 06-11-8896 dt. 15.02 2019



Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Drenas, në përputhje me nenin 8, të Ligjit të Punës nr. 03/L- 212, Nenit 14. par.2. të Ligjit për Shëndetësi Nr.04/L-125, Udhëzimit Administrativ nr. 07/2017, për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, publikon këtë:

K O N K U R S

Për pranim në marrëdhënie pune,

TITULLI I VENDIT TË PUNËS: Zyrtar Ligjor në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare,

- Një (1) pozitë,
- Kategoria dhe grada e vendit të punës,
- Koeficienti; H-30 –H-565,
- Orari: 40 orë në javë,
- Kohëzgjatja e emërimit: - Me kohë të pacaktuar.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Përpilon aktet e përgjithshme dhe ato normative,
- Bënë përpunimin juridiko - profesional të të gjitha lëndëve të cilat arrin për marrjen e mendimit juridik,
- Përpilon të gjitha kontratat,
- Përcjellë ligjet, aktet normative dhe njofton Drejtorin në bazë të kërkesës, për obligimet që burojnë nga ato.
- Kryen të gjitha punët juridiko - administrative sipas urdhrat të Drejtorit,
- Merr pjesë në komisione dhe mbledhje të ndryshme me qëllim të dhënies së sqarimeve juridike,
- Ofron ndihme juridike për zhvillimin e procedurës disiplinore,

Kushtet e konkursit:

Kandidati/ja të cilët konkurrojnë për këtë vend të punës përveç kushteve të përgjithshme të parapara me Ligj duhet të kenë:

- Fakultetin Juridik,(Jurist i diplomuar)

- 2 vite përvoja pune,
- Njohja e punës me kompjuter,
- Njohja e Gjuhës Angleze e preferushme,

Dokumentet e kërkuara:

- Diploma universitare e noterizuar
- Kopjen e letërnjoftimit apo të pasaportës

-Dëshmi për përvojën e punës, -Dëshminë e kandidatit që nuk është nën hetime
 -Çdo dokument tjetër apo certifikatë trajnimi që kandidati/ja e vlerëson të nevojshme që i përshtatet kushteve dhe kriterëve të përcaktuara më lartë. Kandidati që përzgjidhet në këtë vend pune, obligohet që ta sjell Certifikatën Shëndetësore para nënshkrimit të kontratës.

Data e shpalljes së Konkursit 15.02.2019, deri më datë 02.03.2019.

Aplikacioni merret dhe dorëzohet në objektin e Komunës së Drenasit, kati i parë, sporteli nr.10-12, nga ora 8-16.

Dokumentacioni i cili i bashkëngjitet aplikacionit duhet të jetë kopje dhe i njëjti nuk kthehet.

Dokumentacioni i cili nuk i`u përgjigjet kërkesave dhe specifikave të konkursit si dhe dokumentacioni i pa kompletuar, dhe ai që mbërrin me vonesë nuk do të shqyrtohen. Për zhvillim të intervistës me shkrim dhe me gojë, do të njoftoheni me kohëpërmes ueb faqes së komunës, si dhe njoftimit në hyrje të ndërtesës së Komunës së Drenasit.

Drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe M.S.



Dr. Arsim Haxhiu